



Një tjetër urë komunikimi

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (AKK) i ka shtuar përpjekjet për transparencë dhe komunikim me publikun gjatë kohëve të fundit. Edhe ky buletin që e keni përpara është një hap modest drejt afrimit me qytetarët, sektorin e biznesit, institucionet lokale dhe qendrore si dhe palët e tjera të interesit.

Përmes kësaj forme të komunikimit - që ne kemi vendosur ta publikojmë çdo tre muaj - synojmë që të ju mbajmë të informuar me zhvillimet kryesore rreth punës së Autoritetit por edhe të

avokojmë sa më shumë për misionin tonë, në mënyrë që gjatë rrugës të krijojmë edhe më shumë bashkëpunëtorë e partnerë në përpjekjet tona për të garantuar konkurrencën në vend.

Viti 2020 e gjen Autoritetin një institucion të reformuar por të përkushtuar që të përmirësojë tutje punën në shërbim të qytetarëve të Kosovës. Si kryetar i AKK-së, unë angazhohem që institucioni ynë të jetë i hapur për bashkëpunim me të gjithë dhe jam i bindur se me këtë nismë po krijojmë edhe një urë të dobishme të komunikimit.

Lexim të këndshëm të edicionit të parë,
Valon Prestreshi, Kryetar i Autoritetit

Shkurtimisht rreth rolit të Autoritetit të Konkurrencës

Siç e dini, në Kosovë ekzistojnë një numër institucionesh të pavarura, të cilat mbulojnë fusha të caktuara, bazuar në mandatin që u caktohet nga ligjet në fuqi. Autoriteti është një prej këtyre institucioneve, që është formuar nga Kuvendi i Kosovës me qëllim që ta mbikqyrë sistematikisht tregun e Kosovës për të parandaluar çfarëdo shkelje të mundshme të konkurrencës.

Çfarë janë këto shkelje të konkurrencës? ➡

Bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, ndalohen të gjitha marrëveshjet ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjeve të pavarura, vendimet e marrura në mes të shoqatave të ndërmarrjeve dhe praktikave të bashkërenduara, të cilat kanë për qëllim

ose mund të ndikojnë në çrregullimin e konkurrencës tregtare. Më konkretisht, ato marrëveshje që:

- ✚ caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi
- ✚ kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet
- ✚ ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit
- ✚ zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta me ndërmarrje të tjera tregtare, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurruese e të tjera.

Çfarë bën pastaj Autoriteti kur identifikon shkeje të tilla ligjore?

Pas kryerjes së hetimeve, vendimi për caktimin e dënimeve i takon Komisionit të AKK-së, që përbëhet nga pesë zyrtarë. Dënimet për subjektet që kanë shkelur ligjin mund të arrijnë deri në 10 për qind të qarkullimit vjetor të një kompanie.

Në Autoritetin e Konkurrencës ka divizione të ndryshme që funksionojnë në kuadër të Departamentit për Mbikqyrjen e Tregut. Për shembull, ekziston Divizioni që mbikqyrë Pozitën Dominuese, një Divizion për Marrëveshjet e Ndaluar, Divizioni i Bashkimeve/Përqendrimeve e të tjera. Në kuadër të këtyre divizioneve janë të angazhuar inspektorët hetues.

Komisioni dhe drejtuesit e AKK-së propozohen nga qeveria kurse zgjidhen nga Kuvendi i Kosovës, që poashtu e mbikqyrë punën e Autoritetit.



Prioritetet për vitin 2020 të Projektit të financuar nga BE

Kryetari i Autoritetit, Valon Prestreshi, ka zhvilluar një takim në muajin janar me Dr. Eugene Stuart, Udhëheqës i Projektit *“Mbështetja e BE-se për Autoritetin Kosovar të Konkurrencës dhe Komisionin për Ndhmë Shtetërore”*. Zyrtarët e Autoritetit dhe ata të Projektit janë dakorduar për një numër të konsiderueshem të aktiviteteve që do të zhvillohen në kuadër të këtij projekti, që për synim ka ta ndihmojë Kosovën në fushën e konkurrencës dhe ndihmës shtetërore.

Gjatë vitit 2019, si pjesë e këtij projekti, janë mbajtur numër i konsiderueshëm i trajnimeve të stafit të AKK-së lidhur me praktikën më të mira të konkurrencës në vendet e Bashkimit Evropian. Gjatë vitit 2020, këto trajnime do të vazhdojnë, dhe janë të fokusuar në fusha të ndryshme.

Ky projekt ka filluar së zbatuari në vitin 2019 dhe pritet të zgjasë deri në maj të vitit 2022. Projekti financohet nga Bashkimi Evropian.

Një Strategji gjithpërfshirëse për tri vitet e ardhshme

Vitin 2020 AKK e ka nisur me një Strategji të re, e cila është miratuar më 27 dhjetor të vitit 2019 nga Komisioni i Autoritetit. Ky dokument do të shërbejë si udhërrëfyes i rëndësishëm i punës dhe objektivave që AKK synon t'i arrijë në vitet 2020-2023.

Prioritet më i theksuar i është kushtuar tri fushave: fuqizimi i kapaciteteve profesionale dhe administrative në funksion të zbatimit të Ligjit të Konkurrencës; promovimi i politikave të konkurrencës; si dhe realizimi i obligimeve që dalin nga procesi i integritimit evropian. Procesi i integritimit nënkupton edhe plotësimin e zbrazëtive ligjore dhe përafrimin me *acquis* të Bashkimit Evropian.

Poashtu, rëndësi e posaçme i është kushtuar edhe bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e politikës së konkurrencës si dhe ofrimin e ekspertizës dhe këshillave për politikën e konkurrencës për Qeverinë e Kosovës dhe institucioneve tjera.

Rasti “Nafta” dhe angazhimet gjatë pandemisë COVID-19

Një nga rastet më të rëndësishme në të cilin AKK ka qenë i përqëndruar ka të bëjë me rastin që në media është quajtur si “Nafta”. Hetimi lidhur me këtë rast kishte filluar në fillim të vitit 2019, kur ishin ngritur dyshime se operatorët e shitjes së këtyre derivateve nuk kishin reflektuar në mënyrë individuale gjatë caktimit të çmimeve gjatë muajve nëntor dhe dhjetor të vitit 2018, kur çmimi në tregun e Kosovës kishte mbetur i njëjti përkundër rënies së çmimit në berzën ndërkombëtare.

Gjatë muajit shkurt, Autoriteti ka organizuar seanca dëgjimore me kompanitë e dyshuara lidhur me këtë

rast. Një vendim përfundimtar pritet që të merret pasi institucioni të rifillojë punën normalisht dhe të analizohen komentet e palëve. Ashtu sikurse institucionet e tjera, AKK po punon me kapacitete të kufizuara për shkak të përhapjes së pandemisë COVID 19.

Gjatë kësaj kohe, Autoriteti ka qenë poashtu i angazhuar që në mënyrë intenzive të bëjë monitorimin e tregut, pas dyshimeve për ngritje të çmimeve të disa produkteve bazë si pasojë e përhapjes së pandemisë. AKK ka mbajtur një mbledhje urgjente të sturkturave drejtuese ku është vendosur që kjo çështje të trajtohet me prioritet të lartë. Në këtë kontekst, inspektorët hetues kanë bërë monitorim të tregut lidhur me këto dyshime.

Zyrtarët e AKK-së marrin pjesë në konferenca ndërkombëtare

Zyrtarët e AKK kanë marrë pjesë në tri konferenca, të zhvilluara në vende të ndryshme të Bashkimit Evropian. Përgjithësisht, këto konferenca kanë pasur si temë forcimin dhe avokimin për konkurrencë në sektorë

të ndryshëm të ekonomisë. Drejtori i Përgjithshëm, Sakip Imeri, së bashku me disa anëtarë të Komisionit, kanë marrë pjesë në një konferencë të OECD-së në Paris.

Kurse, Inspektorët Hetues, Shyhrete Bytyqi dhe Adrian Mustafa, kanë marrë pjesë në seminare të organizuara në Budapest dhe Vjenë.

Zyrtarët e Autoritetit trajnohen për konkurrencën në prokurim publik



Në shkurt, zyrtarët e AKK-së kanë marrë pjesë në seminarin “Promovimi i Kulturës së Konkurrencës në Prokurim Publik”. Këtë aktivitet e kanë zhvilluar ekspertët lituanëzë të konkurrencës në kuadër të Projektit Mbështetja e BE-së për Autoritetin Kosovar të Konkurrencës dhe Komisionin e Ndihmës Shtetërore.

Ndër tjerash, ekspertët kanë bërë prezantimin e Raportit për pajtueshmërinë e legjislacionit kosovar për prokurim publik me rregullat e konkurrencës.

AKK dhe Policia e Kosovës nënshkruajnë memorandum për kontrolle të paparalajmëruara



Në muajin mars, Autoriteti ka nënshkruar një memorandum bashkëpunimi me Policinë e Kosovës, që ndër të tjerash u mundëson zyrtarëve të AKK-së të kërkojnë mbështetjen e policisë për të kryer kontrolle të paparalajmëruara (*dawn raids*) tek subjektet që janë të dyshuara për shkeljen e rregullave të konkurrencës.

Nënshkrimin e memorandumit e kanë bërë kryetari i AKK-së, Valon Prestreshi, dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj.

Prestreshi ka falënderuar Policinë e Kosovës për gatishmërinë e treguar për të thelluar bashkëpunimin në mes të dy palëve. Sipas tij, ky memorandum e lehtëson punën e zyrtarëve të AKK-së.